



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**NJOFTIM PËR MEDIAT**

**1. Kërkuesi Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **13.11.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Pushimin e procedimit penal me nr. 137/12, të vitit 2024, për veprën penale “*Refuzim për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*” parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk ekziston”.

**2. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, me vendimin nr. 174, datë 09.12.2025, vendosi:**

- 1.** Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- 2.** Pushimin e procedimit penal me nr. 137/12, të vitit 2024, për veprën penale “*Refuzim për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*” parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.
- 3.** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

**Tiranë, më datë 09.12.2025**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**